



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3153/11 prot.

Datë 05.12.2025

V E N D I M
Nr. 1810/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.12.2025 me

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1696/2025, datë 18.11.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-63770-10-06-2025, me objekt: “Loti 4 Mannitol”, me fond limit 380,896.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 22-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “M E D I C A M E N T A” SHPK me NIPT (K41420001V), me adresë: Autostrada Tirane Dures, Km 6, Ndertesa dy kateshe nr. 5, kati i I i nderteses.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara., me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi nr. 285, datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit 2 Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 18.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1696/2025, ku vendosi:

1. *“Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “M E D I C A M E N T A” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-63770- 10-06-2025, me objekt: “Loti 4 Mannitol”, me fond limit 380,896.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 22-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.*
 2. *Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me këtë vendim dhe konstatimet e Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për operatorin ekonomik “M E D I C A M E N T A” SHPK.*
 3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
 4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “M E D I C A M E N T A” SHPK.*
 5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*

I.2. Me shkresën nr.3188/37 prot., datë 27.11.2025, protokolluar me tonën nr. 3153/8 prot., datë 02.12.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara, informon se ka zbatuar

vendimin Nr. 1696/2025, datë 18/11/2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-63770- 10-06-2025, me objekt: “Loti 4 Mannitol”, me fond limit 380,896.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 22-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.3188/37 prot., datë 27.11.2025, protokolluar me tonën nr. 3153/8 prot., datë 02.12.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1696/2025, datë 18/11/2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-63770- 10-06-2025, me objekt: “Loti 4 Mannitol”, me fond limit 380,896.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 22-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2. Referuar shkresës së dorëzuar nga autoriteti kontraktor me nr.3188/37 prot., datë 27.11.2025, protokolluar me tonën nr. 3153/8 prot., datë 02.12.2025, ku autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1696/2025, datë 18/11/2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 1696/2025, datë 18/11/2025, nga ku rezultoi, se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në zbatim të vendimit të Komisioni i Prokurimit Publik Nr. 1696/2025, datë 18/11/2025.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, që autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 1696/2025, datë 18/11/2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor, për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-63770- 10-06-2025, me objekt: “Loti 4 Mannitol”, me fond limit 380,896.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 22-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

